



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
**Qeveria - Vlada – Government**

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/Ministarstvo Obrazovanja i  
Nauke, Tehnologije i Inovacija / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation*

**V.Nr.4/4-12/2024**

**Datë: 20.05.2024**

Njësia e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në pajtim me dispozitat e nenit 38 paragrafit 1, 7 dhe 8 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, duke u bazuar në dispozitat e nenit 99 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe në pajtim me dispozitat e nenit 7 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për procedurën e pranimit në shërbimin civil, në vijim të procedurës së verifikimit paraprak të aplikacioneve për konkursin me kod RPC0007296; RPC0007297; RPC0007298; RPC0007299; RPC0007300; RPC0007301 dhe RPC0007302 të shpallur me datë 05.04.2024 nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/Inspektoriati i Arsimit për pozitën „Inspektor i Arsimit”, nxjerr këtë:

**V E N D I M**  
**për vazhdimin e afatit**

1. Për shkak të kompleksitetit të çështjes administrative, shtyhet afati për përfundimin e procedurës së verifikimit të aplikacioneve për konkursin me kod RPC0007296; RPC0007297; RPC0007298; RPC0007299; RPC0007300; RPC0007301 dhe RPC0007302 edhe për 15 ditë të tjera pas përfundimit të afatit fillestar për përfundimin e kësaj procedure.
2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.
3. Vendimi publikohet në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore si dhe në ueb faqen e ministrisë.

**A r s y e t i m**

Duke marr parasysh numrin e madh të aplikacioneve të pranuar për konkursin me kod RPC0007296; RPC0007297; RPC0007298; RPC0007299; RPC0007300; RPC0007301 dhe RPC0007302 të shpallur me datë 05.04.2024 nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit/Inspektoriati i Arsimit për pozitën „Inspektor i Arsimit” gjithësej 696 aplikacione, për shkak të kompleksitetit të çështjes administrative konkrete gjegjësisht vëllimit shumë të madh të aplikacioneve, në pamundësi të përfundimit të procesit të verifikimit brenda afatit fillestar, në pajtim me dispozitat e lartëcekura u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Njësia e Burimeve Njerëzore**

**Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit**

